

Milovanit. Ajo u varros në varrezat e Pejës/Peç. Në muajin qershor të vitit 2006, u bë zhvarrimi dhe identifikimi në bazë të ADN analizës, dhe u konstatua se kufoma nuk ishte e Milovanit. Zhdukja e tij është evidentuar nga KNKK-ja me numrin rendor BLG-805022-01.

Kufoma e Milkes u identifikua në muajin tetor të vitit 2004. Ajo u zhvarros nga varrezat në fshatin Piskotë/Piskot [Gjakovë/Đakovica], në të cilat janë varrosur kufomat e paidentifikuara nga kanali i *Liqenit të Radoniqit/Radonjičko jezero*. Familjarët i kanë pranuar mbetjet mortore të Milkes në vendkalimin e Merdares/Merdare, më 28.10.2004. Varrimi i saj u bë në varrezat e qytetit Millanovc i Epërm.

Për fatin e Milicës ende nuk dihet asgjë. Rasti i zhdukjes së saj është evidentuar nga KNKK-ja me numrin rendor YUK-050076-01.

Burimet: deklarata N.V, FDH-5566; deklarata N.V, FDH-27350; deklarata N.V, FDH-11349; deklarata U.L, FDH-12384; deklarata N.V, FDH-31724; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; FDH, *Fati i serbëve...*, 9, 10, FDH-14277; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; ICTY, IT-04-84 (R.Haradinaj dhe të tjerë), aktgjykimi, 03.04.2008, [http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaReforma&int_cid=124&cat=Transkripti/Predmet-Haradinaj-i-drugi-\(-IT-04-84-\)](http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaReforma&int_cid=124&cat=Transkripti/Predmet-Haradinaj-i-drugi-(-IT-04-84-)).

Darinka (Radovan Vujošević)

Kovač

(18.09.1932, malazeze nga Ratishi i Epërm/Gornji Ratiš, komuna e Deçanit/Deçani)

Vukosava (Radovan Vujošević)

Marković

(9.08.1937, malazeze nga Ratishi i Epërm/Gornji Ratiš, komuna e Deçanit/Deçani)

Motrat Vukosava dhe Darinka ishin parë për herë të fundit, më **21.04.1998**, në fshatin **Ratish i Epërm/Gornji Ratiš**. Trupat e tyre të pajetë u gjetën më 12.09.1998, në kanalim e *Liqenit të Radoniqit/Radonjičko jezero*. E bija e Darinkes, Vera i kishte identifikuar disa nga rrobat e tyre të trupit. Është konstatuar se janë vrarë me armë zjarri, ndërkaq Vukosava ishte e mbështjell me tel përreth trupit. Darinka dhe Vuko-

sava janë varrosur më 19.09.1998 në varrezat e fshatit Piskotë/Piskot [Gjakovë/Đakovica]. Ky lokalitet u zhvarros dy herë gjatë vitit 2005, por mbetjet mortore të Darinkes dhe Vukosaves nuk janë gjetur.

Burimet: deklarata N.V, FDH-5566; deklarata N.V, FDH-27350; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; Z. Stijović, *Kosmet...*, 109; ICTY, IT-04-84 (R.Haradinaj dhe të tjerë), aktgjykimi, 03.04.2008, [http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaReforma&int_cid=124&cat=Transkripti/Predmet-Haradinaj-i-drugi-\(-IT-04-84-\)](http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaReforma&int_cid=124&cat=Transkripti/Predmet-Haradinaj-i-drugi-(-IT-04-84-)).

Miloš (Batrić) Radunović

(19.02.1938, serb nga Dashinoci/Dašinovac, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, tre fëmijë)

Slobodan (Mirko) Radošević

(8.10.1934, serb nga Dashinoci/Dašinovac, komuna e Deçanit/Deçani)

Shumica e serbëve, kryesisht të moshuar, që kanë jetuar në fshatin **Dashinoc/Dašinovac** u zhvendosën nga shtëpitë e veta më 21.04.1998. Kanë mbetur vetëm Miloš Radunović, Slobodan Radošević dhe familja Marković. Djali i Slobodanit, Staniša, ka shkuar në fshat më **22.04.1998**. Tentoi që ta bindte të atin të nisej me të. I ka treguar atij për rrëmbimin e së ëmës, duke theksuar se UÇK-ja i kishte vënë postblloqet përreth fshatit dhe se askush nuk mundte të lëvizte më lirshëm. Slobodani i ishte përgjigjur se ai vet do të shkonte në Deçan/Deçane natën dhe nëpër mal. Ishte kjo hera e fundit kur Staniša e kishte parë të atin të gjallë. Ditën tjetër, te Staniša ka ardhur Slaviša Marković. I tha se po vinte nga Dashinoci/Dašinovac, ku një natë më parë, nga ora 19:00, kishte dëgjuar të shtëna nga drejtimi i shtëpisë së familjes Radošević, dhe se me gjasë Slobodani u zu rob apo u vra. Nga një serb tjetër, Staniša ka dëgjuar se ky i kishte vërejtur ushtarët e UÇK-së më 22.04.1998, duke i çuar me veturë Miloš Radunovićin dhe Slobodan Radoševićin në drejtim të fshatit Pozhare/Požar. Ky dëshmitar ka vërejtur gjithashtu se ata kanë qenë të keqtrajtuar fizikisht. Në fillim të muajit shtator të vitit 1998, pjesëtarë të MPB-së së Serbisë i kanë zbuluar kufomat